

UDHËZIM
Nr. 23, datë 13.8.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Pika 77.7 e udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ndryshon si vijon:

- a) Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore si rezultat i një vlerësimi tatimor të kryer, sipas nenit 68, të ligjit në fuqi “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për detyrime tatimore të vetëdeklaruar (vetëvlerësimi) nga tatimpaguesi.
- b) Pavarësisht sa përcaktohet në shkronjën “a”, të mësipërcituar, administrata tatimore nuk hyn në një marrëveshje të pagesës me këste, vetëm për detyrim tatimor mbi të ardhurat të mbajtur në burim dhe të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, si dhe për detyrim nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tatimpaguesit.
- c) Përjashtimisht, në rastet kur në cilësinë e tatimpaguesit janë institucione apo ente shtetërore apo publike, qendrore apo vendore apo ente të tjera ku shteti është palë, për raste të një interesi të lartë publik ose të nevojës për moslejimin e cenimit të rendit dhe të sigurisë kombëtare, mund të lidhet një marrëveshje me këste edhe për detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- d) Në çdo rast, për lidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste, duhet të përmbushen kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 77, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe marrëveshja nuk lehtëson pozitën ligjore të personit përgjegjës në rastet e prezumimit apo konsumimit të veprës penale së parashikuar ligjërisht lidhur me detyrimin tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

BOTUAR NË FLETOREN ZYRTARE NR. 118, DATË 16.08.2019